



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSUE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Mësimi Org. Org. Jeshmice Org. Unit	AQP
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	34/20
Nr. T. Fajev Br. Stranica No. Pages	1/28
Prishtinë / a	
Data : 28.02.2020	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije i Transfere–
Ministry of Finance and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

RAPORT VJETOR I PUNËS I AGJENCISË QENDRORE TË
PROKURIMIT
PËR VITIN 2019

PËRMBAJTJA

- Baza Ligjore
- Struktura Organizative
- Aktivitetet e Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara
- Aktivitetet e Drejtoratit për Prokurime të Veçanta
- Aktivitetet e Drejtoratit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
- Pjesëmarrje në Konferencë Ndërkombëtare
- Trajnimet

BAZA LIGJORE

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

AQP është Subjekt i Sektorit Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik mandatohet si organ qendror për prokurime të centralizuara qoftë në nivel qendror (Ministri) apo nivel lokal (Komuna).

AQP, konform nenit 95, pika 2 e Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Udhëzimeve Administrative, pas propozimit të Ministrit të Ministrisë së Financave dhe miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zhvillon aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara. Kryerja e procedurave të centralizuara bëhet në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve të përdorimit të përbashkët.

Kryerja e aktiviteteve të prokurimit për procedura të centralizuara do të bëhet në koordinim të ngushtë në mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, Ministrisë së Financave dhe Autoriteteve Kontraktuese të cilat janë shfrytëzues të kontratave sipas listës së artikujve të përbashkët.

AQP është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrim të kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës do të bëhet nga Autoritetet Kontraktuese të cilat i shfrytëzojnë këto kontrata. Të gjitha obligimet monetare që rrjedhin për këto kontrata do t'i paguajnë Autoritetet Kontraktuese nga kodet e tyre buxhetore

AQP është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të parapara më Nenin 95 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë (Ligji Nr. 04/L-042), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 në lidhje me zhvillimin dhe implementimin e aktiviteteve të prokurimeve të centralizuara dhe atyre specifike në Republikën e Kosovës, si në vijim:

- Kryen aktivitete specifike të prokurimit për dhe në emër të autoriteteve kontraktuese, të cilat do të kryhen pas një vendimi përkatës të Ministrit të Financave (MF);
- Kryen prokurime të centralizuara për artikuj të përdorimit të përbashkët, lista e të cilave miratohet në formë të një Udhëzimi Administrativ sipas propozimeve të MF dhe aprovimin përkatës nga qeveria;
- Kryen prokurimin për çfarëdo mallra, punë ose shërbime sipas kërkesës nga një autoritet kontraktues të aprovuar nga MF;
- Zbaton nenin 21/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht kryen prokurime për 16 agjenci të pavarura më së pak se 50 të punësuar të cilat i raportojnë Kuvendit të Kosovës.

- Asiston autoritetet kontraktuese me kërkesën e tyre, gjatë implementimit të aktiviteteve të prokurimit që udhëhiqen nga vetë autoritetet kontraktuese në të gjitha fazat e aktiviteteve të prokurimit.

Për më shumë, Agjencia Qendrore e Prokurimit asiston cilindo autoritet kontraktues në kryerjen e çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është duke u kryer, pas një kërkesë përkatëse nga autoriteti kontraktues në fjalë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoria për Prokurime të Centralizuara

- Sektori për Prokurime të Centralizuara;
- Sektori për Punë dhe Shërbime.


Drejtoria për Prokurime të Veçanta

- Sektori për Aktivitete të Prokurimit për Autoritetet Kontraktuese;
- Sektori për Prokurime nga Donacionet.

Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

- Drejtor i Drejtorit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Zyrtare ligjore;
- Zyrtare e lartë e personelit;
- Përkthyeset;
- Zyrtar i logjistikës.

STUKTURA ORGANIZATIVE E BRENDSHME E AGJENICISË QENDRORE TË PROKURIMIT



Shkurt, 2020

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara

Qëllimi dhe përfitimet

- Me prokurime të centralizuara sigurohen çmime më të mira, gjegjësisht, kontrata më të dobishme për Autoritetet kontraktuese / Njësitë kërkuese si shfrytëzuese të atyre kontratave;
- Specifikimet për mallra dhe shërbime standardizohen dhe me këtë krijohet mundësia që shumë shfrytëzues të këtyre kontratave të përfitojnë mallra apo shërbime kualitative;
- Eliminohet në tërësi mundësia e situatave të 'konfliktit të interesit' meqë palët kontraktuese dhe implementuesit e kontratave janë krejtësisht të ndryshëm dhe ndikimi qoftë edhe i supozuar do të mungojë;
- Puna e përbashkët (në organizim të AQP-së) e shumë AK- njërive kërkuese në hartimin e specifikave teknike dhe në procesin e vlerësimit të ofertave ngritë përgatitjen profesionale të tyre, sigurinë dhe besimin në vetë-vete dhe shkëmbimin e përvojave.
- Drejtorati i prokurimeve të centralizuara duke i publikuar të gjitha kontratat (së bashku me ofertën fituese) në web-faqen e AQP-së paraqet shembull për të gjitha AK për transparencë të plotë në raport me palët e interesuara dhe çdo qytetar tjetër.
- Procedurat e ankimimit do të jenë më funksionale sepse në vend të disa ankesave nga Operator ekonomik të pakënaqur, mund të bëhet vetëm një ankesë ndaj një propozimi të AQP-së gjë që kursen mjete financiare dhe angazhime tjera të stafit të AK-ve.

Agjencia Qendrore e Prokurimit, gjatë periudhës: 01.01.2019 deri më 31.12.2019, me sukses ka kryer aktivitetet e prokurimit, konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Udhëzimeve Administrative të aprovuara nga Qeveria e Kosovës, si në vijim:

Tabela nr. 1. Aktivitetet e Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara

<i>Nr. rendor</i>	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të kontraktues	Vlera e parashikuar	Të kontraktuara	Lloji i kontratës
1	Furnizim me material zyrtar Lot I	31.05.2019	€ 301,000.00	€ 261,900.92	Kontratë kornizë
2	Furnizim me material zyrtar Lot II	31.05.2019	€ 189,000.00	€ 186,648.13	Kontratë kornizë
3	Furnizim me material zyrtar Lot III	31.05.2019	€ 1,731,000.00	€ 1,294,420.00	Kontratë kornizë
4	Furnizim me material zyrtar Lot IV	31.05.2019	€ 256,000.00	€ 105,060.62	Kontratë kornizë
5	Furnizim me material zyrtar Lot V	31.05.2019	€ 148,000.00	€ 114,961.54	Kontratë kornizë
6	Furnizim me material zyrtar Lot VI	31.05.2019	€ 152,000.00	€ 119,939.34	Kontratë kornizë
7	Furnizim me material zyrtar Lot VII	31.05.2019	€ 191,000.00	€ 128,697.00	Kontratë kornizë
8	Furnizim me goma per automjete Lot I	01.11.2019	€ 575,000.00	€ 442,277.30	Kontratë kornizë
9	Furnizim me goma per automjete Lot II	01.11.2019	€ 575,000.00	€ 503,640.95	Kontratë kornizë
10	Shërbime të fotokopjimit Nivel Lokal, Lot 1	26.03.2019	€ 585,000.00	€ 357,500.00	Kontratë me qira
11	Shërbime të fotokopjimit Nivel Lokal , Lot 2	27.03.2019	€ 360,000.00	€ 340,000.00	Kontratë me qira
12	Shërbime të fotokopjimit Nivel Lokal , Lot 3	26.03.2019	€ 540,000.00	€ 366,000.00	Kontratë me qira

13	Shërbime të fotokopjimit Nivel Lokal, Lot 4	26.03.2019	€ 315,000.00	€ 206,500.00	Kontratë me qira
14	Shërbime të fotokopjimit Nivel Lokal, Lot 5	26.03.2019	€ 180,000.00	€ 118,000.00	Kontratë me qira
15	Shërbime të fotokopjimit Nivel lokal, Lot 6	27.03.2019	€ 315,000.00	€ 262,500.00	Kontratë me qira
16	Furnizim me Karburante	12.02.2019	€ 4,795,690.00	€ 50,314.40	Procedurë e negociuar
17	Furnizim me Karburante	12.02.2019	€ 4,795,690.00	€ 50,314.40	Procedurë e negociuar
18	Furnizim me Karburante (benzin dizell) LOT 1	02.05.2019	€ 11,359,500.00	€ 11,348,228.85	Kontratë kornizë
19	Furnizim me Karburante (benzin dizell) LOT 2	02.05.2019	€ 7,372,400.00	€ 6,722,328.27	Kontratë kornizë
20	Furnizim me Karburante (benzin dizell) LOT 3	02.05.2019	€ 5,440,700.00	€ 5,430,363.84	Kontratë kornizë
21	Furnizim me Karburante (benzin dizell) LOT 4	02.05.2019	€ 2,866,200.00	€ 2,882,742.72	Kontratë kornizë
22	Furnizim me Karburante (benzin dizell) LOT 5	02.05.2019	€ 8,069,750.00	€ 5,237,305.92	Kontratë kornizë
23	Furnizim me Inventar Lot 2	01.11.2019	€ 1,500,000.00	€ 816,425.00	Kontratë kornizë
24	Furnizim me Inventar Lot 3	30.08.2019	€ 1,600,000.00	€ 572,050.00	Kontratë kornizë
25	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 1 - Lot 1	19.11.2019	€ 6,300,000.00	€ 5,496,397.17	Kontratë kornizë
26	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 1 - Lot 2	25.11.2019	€ 1,500,000.00	€ 1,311,302.25	Kontratë kornizë
27	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 2 - Lot 1	20.11.2019	€ 2,800,000.00	€ 2,047,953.45	Kontratë kornizë

28	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 3	09.10.2019	€ 2,000,000.00	€ 1,656,481.46	Kontratë kornizë
29	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 4 - Lot 1	20.11.2019	€ 3,400,000.00	€ 2,796,971.86	Kontratë kornizë
30	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 4 - Lot 2	19.11.2019	€ 2,800,000.00	€ 1,899,257.43	Kontratë kornizë
31	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 5 - Lot 1	10.09.2019	€ 2,000,000.00	€ 1,773,864.60	Kontratë kornizë
Gjithsej			€ 75,012,930.00	€ 54,900,347.42	

Tabela nr. 1

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 1 shihet se vlera e parashikuar e kontratave nga Autoritetet Kontraktuese që kanë paraqitur kërkesat në Agjencinë Qendrore të Prokurimit për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit është € 75,012,930.00, ndërsa vlera e kontraktuar e këtyre procedurave është € 54,900,347.42. Gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve të prokurimit është arritur që të kursehen mjete në vlerë prej €20,112,582.58, shprehur në përqindje, vlera e kursimeve është 26.81%.

Shënim: Në këtë analizë janë të përfshira vetëm kontratat e nënshkruara.

Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës dhe punës profesionale që kanë treguar zyrtarët e Agjencisë Qendrore të Prokurimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.


Grafiku nr. 1. Paraqitja grafike e aktiviteteve të prokurimit sipas llojit të kontratës:

- Kontrata për furnizime; dhe,
- Kontrata qiramarrje;



Gjatë vitit 2019 janë nënshkruar gjithsej njëzet e pesë (25) kontrata për furnizime në vlerë prej € 53,249,847.42, kurse për shërbime të marrjes me qira janë nënshkruar gjashtë (6) kontrata në vlerë prej € 1,650,500.00.

Grafiku nr. 2. Paraqitja grafike e kontratave në Drejtoratin e Prokurimeve të Centralizuara për vitin 2019



Aktivitetet e prokurimeve të centralizuar të cilat nga 31.12.2019 janë në procedurë:

Nr. rendor	Titulli i Kontratës	Gjendja	Vlera e parashikuar
1	Furnizim me Inventar Lot 1	Në procedurë	€ 250,000.00
2	Furnizim me pajisje te teknologjise informative	Në procedurë	€ 5,400,000.00
3	sherbime te transportit ajror	Në procedurë	€ 7,000,000.00
4	Furnizim me karburante (benzin Dizel)- Nivel lokal	Në procedurë	€ 23,786,363.66
5	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 5 - Lot 2	Në procedurë	€ 2,200,000.00
6	Furnizim me letër - niveli lokal	Në procedurë	€ 1,480,000.00
7	Furnizim me pemë dhe perime	Në procedurë	€ 3,000,000.00
8	Furnizim me material shpenzues zyrtarë - Niveli Lokal	Në procedurë	€ 500,000.00
9	Furnizim me bylmet - Niveli Lokal	Në procedurë	€ 750,000.00
Gjithsej			€ 44,366,363.66

Ne fund të vitit 2019, në procedurë kanë mbetur gjithsej nëntë (9) aktivitete në vlerë të parashikuar prej € 44,366,363.66.

Aktivitetet e prokurimeve të centralizuar të cilat janë anuluar gjatë vitit 2019:

Gjatë vitit 2019 janë anuluar 2 procedura të prokurimit

Nr. rendor	Titulli i Kontratës	Gjendja	Vlera e parashikuar
1	Furnizim me artikuj ushqimor-Kategoria 2 - Lot 2	Anuluar	€ 3,800,000.00
2	Furnizim me vetura zyrtare	Anuluar	€ 590,000.00

Drejtorati për Prokurimeve të Veçanta

Drejtorati për Prokurime të Veçanta, gjatë periudhës, 01.01.2019 deri më 31.12.2019, me sukses ka kryer aktivitetet dhe përgjegjësitë me të cilat është i ngarkuar. Në pajtim me Nenin 21/A, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 janë zhvilluar gjithsejtë gjashtëdhjetë e tetë (68) aktivitete të prokurimit. Në mungesë të ofertave të përgjegjshme, disa aktivitete të prokurimit janë anuluar, disa janë ri-tenderuar dhe disa aktivitete të prokurimit kanë qenë të ndara në me shumë se një pjesë (Lot).

Gjatë vitit 2019, janë nënshkruar gjithsejtë tetëdhjetë e një (81) kontrata me operatorë ekonomik.

Tabela nr.1

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROKURIMIT						
N r.	Lloji i Prokurimit	Vlera e kontratave			Kursimi në vitin	
		2017	2018	2019	2019	2019
1	Furnizime	343,125.87	448.601.00	€ 587,622.56	€ 222,884.94	27.49%
2	Shërbime	937,768.35	584,279.00	€ 838,712.48	€ 207,034.84	19.79%
3	Punë	0.00	0.00	€ 10,134.00	€ 1,256.00	11.02%
Gjithsej		1,280,894.22	1,032,880.00	€ 1,437,889.04	Vlera: € 431,255.78	23.07 %

Siç shihet në tabelën nr.1 Drejtorati i Prokurimeve të Veçanta, gjatë vitit fiskal 2019 ka nënshkruar kontrata për furnizime në vlerë prej **€ 587,622.56**, për shërbime në vlerë prej **€ 838,712.48**, ndërsa për punë ka nënshkruar kontrata me vlerë **€ 10,134.00**, ku krahasuar me vlerat e parashikuara për këto aktivitete, ne kemi arritur që të kursejmë **€ 431,255.78** ose shprehur në përqindje prej **23.07 %**.

TABELA 2

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT		
Nr.	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratave:
1	Procedure e hapur	€ 910,259.17
2	Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës	€ 458,210.00
3	Procedura e kufizuar	€ 5,161.00
4	Procedurë e kuotimit të çmimeve	€ 41,946.15
5	Procedurë e vlerës minimale	€ 22,312.72
Gjithsejtë		€ 1,437,889.04

Në tabelën nr.2 kemi pasqyruar vlerat e kontratave sipas llojit të procedurave të prokurimit. Me procedurë të hapur janë nënshkruar kontrata në vlerë prej € 910,259.17, me procedurë të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës kemi nënshkruar tri kontrata në vlerë prej € 458,210.00, me procedurë të kufizuar kemi pasur vetëm një kontratë të nënshkruar në vlerë prej € 5,161.00, ndërsa për procedurën e kuotimit e çmimeve në vlerë prej € 41,946.15 dhe me procedurë me vlerë minimale € 22,312.72.

TABELA 2.3

LISTA E AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT QË KANË PËRFUNDUAR ME NËNËSHKRIM KONTRATË			
Nr.	Numri i prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar në €
1	AQP-AK-19-001-247	Sigurimi fizik i objektit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit	€ 600.00
2	AQP-AK-19-002-247	Sigurimi fizik i Objektit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.	€ 870.00
3	AQP-AK-19-003-215	Mirëmbajtja e platformës së e-Prokurimit Publik për nevojat e	€ 160,134.00

		Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik		
4	AQP-AK-19-004-247	Sigurimi fizik i Objektivit të Komisionit të Pavarur të Mediave.	€ 990.00	€ 712.80
5	AQP-AK-19-005-247	Sigurimi fizik i Objektivit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.	€ 870.00	€ 870.00
6	AQP-AK-19-006-247	Sigurimi fizik i Objektivit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.	€ 870.00	€ 870.00
7	AQP-AK-19-007-147	Furnizim me fasikla për dosje të ankesave për nevojat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.	€ 997.50	€ 997.50
8	AQP-AK-19-008-236	Shërbimet e back-up për furnizim me internet	€ 3,240.00	€ 1,440.00
9	AQP-AK-19-009-111	Pjesa(lot) 1- Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnit për nevojat e Agjencive të Pavarura	€ 205,265.00	€ 59,888.65
10	AQP-AK-19-009-111	Pjesa(2)-Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnit për nevojat e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik	€ 12,000.00	€ 6,984.00
11	AQP-AK-19-010-221	Shërbimet e pastrimit dhe mirmbajtjes së objekteve të Agjencive të Pavarura	€ 84,962.00	€ 61,158.00
12	AQP-AK-19-011-247	Shërbimet e deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit (DDD) për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	€ 990.00	€ 926.00
13	AQP-AK-19-012-121	Furnizim me licenca për Networks Firewall për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës	€ 15,000.00	€ 14,870.00

14	AQP-AK-19-013-136	Furnizim me letër higjienike dhe tualeti	€ 3,930.00	€ 2,149.75
15	AQP-AK-19-015-221	Pjesa 1: Mirëmbajtja dhe instalimi i pajisjeve të TI, ripërtitja e domenit dhe ueb hostingut	€ 9,000.00	€ 7,317.00
16	AQP-AK-19-015-221	Lot 2: Ridizajnimi dhe zhvillimi i web faqes së ZRRE-së.	€ 8,000.00	€ 4,777.00
17	AQP-AK-19-016-211	Sigurimi Fizik i objekteve	€ 288,200.00	€ 210,157.20
18	AQP-AK-19-017-236	Hulumtimi i Opinioneve të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit në Kosovë	€ 5,000.00	€ 3,490.00
19	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 2 - Furnizim me pajisje të TI-së për Agjencinë kundër Korrupsionit	€ 26,300.00	€ 20,836.00
20	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 3 - Furnizim me pajisje të TI-së për Autoritetin Rregullativ i Hekurudhave	€ 12,000.00	€ 10,725.00
21	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 5 - Furnizim me pajisje të TI-së për Autoritetin e Aviacionit Civil i Kosovës	€ 5,300.00	€ 4,268.00
22	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 7 - Furnizim me pajisje të TI-së për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës	€ 95,080.00	€ 93,375.00
23	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 8 - Furnizim me pajisje të TI-së për Këshillin e pavarur i Mbikëqytës për shërbimin civil të Kosovës	€ 3,000.00	€ 2,475.00
24	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 9 - Furnizim me pajisje të TI-së për Komisionin e pavarur i mediave	€ 7,510.00	€ 3,945.00
25	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 10 - Furnizim me pajisje të TI-së për Komisionin Rregullativ i Prokurimit Publik	€ 5,000.00	€ 3,699.00
26	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 11 - Furnizim me pajisje të TI-së për Këshillin e Kosovës për trashigimi kulturore	€ 8,500.00	€ 5,918.00

27	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 13 - Furnizim me pajisje të TI-së për Zyra e Rregullatorit për Energji	€ 39,000.00	€ 28,670.00
28	AQP-AK-19-018-111	Pjesa 1 - Furnizim me pajisje të TI-së për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas	€ 5,500.00	€ 4,200.00
29	AQP-AK-19-019-215	Përditësimi i Softwerit të Sistemit të Monitorimit për nevojat e Komisionit të Pavarur të Mediave	€ 291,500.00	€ 286,326.00
30	AQP-AK-19-020-236	Ngjyrosja e pjesërishme e veturave të ARRU-së	€ 1,200.00	€ 1,097.00
31	AQP-AK-19-021-211	Shërbime të akomodimit, ushqimit dhe pijeve për pjesëmarrësit në trajnime në regionin e Prishtinës	€ 45,000.00	€ 10,170.00
32	AQP-AK-19-022-136	Furnizim me telefona mobil për nevojat e Agjencisë Kundër Korrupsionit	€ 5,000.00	€ 4,444.00
33	AQP-AK-19-023-121	Furnizim me pajisje për sistem të alarmit dhe kundërzjarrit si dhe IP Kamera	€ 20,000.00	€ 18,490.00
34	AQP-AK-19-024-147	Furnizim me ormana metalik për nevojat e AAK	€ 990.00	€ 979.00
35	AQP-AK-19-025-247	Vendosja e sistemit të alarmit të kompletuar për sigurinë e pasurisë në objektin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas	€ 650.00	€ 420.00
36	AQP-AK-19-026-236	Sigurimi i automjeteve për KPM	€ 6,365.16	€ 5,161.00
37	AQP-AK-19-027-547	Zgjerimi i arkivës dhe rinovimi i zyrave të Agjencisë Kundër Korrupsionit	€ 960.00	€ 957.00
38	AQP-AK-19-028-247	Sigurimi fizik i Objektit të Komisionit të Pavarur të Mediave.	€ 990.00	€ 871.00

39	AQP-AK-19-029-247	Sigurimi fizik i objektit të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit	€ 950.00	€ 945.00
40	AQP-AK-19-030-147	Furnizim me telefona fiks për nevojat e zyrave regjionale të ANJF	€ 510.00	€ 469.40
41	AQP-AK-19-031-147	Furnizim me karrike zyre me rrota për nevojat e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas	€ 990.00	€ 890.00
42	AQP-AK-19-032-121	Furnizim me licence softuer –Dongle për qasje në modulën softuerike SPECTRA emc	€ 35,000.00	€ 34,875.00
43	AQP-AK-19-033-136	Furnizimi dhe montimi i recepsionit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit	€ 1,500.00	€ 1,111.00
44	AQP-AK-19-034-136	Furnizim me tepih dhe perde për nevojat e agjencive të pavarura	€ 5,800.00	€ 2,420.00
45	AQP-AK-19-035-111	Furnizim dhe instalim i paisjeve harduerike për sistem të prokurimit elektronik për nevojat e KRPP	€ 150,000.00	€ 143,865.50
46	AQP-AK-19-036-121	Demolimi, riparimi furnizimi me komponente dhe funksionalizimi i sistemeve mbështetëse të KOSIX dhe ambientit brenda dhe jashtë dhomës së pajisjeve	€ 10,000.00	€ 7,587.50
47	AQP-AK-19-037-247	Servisimi i gjeneratorit për nevojat e Komisionit të Pavarur të Mediave.	€ 720.00	€ 665.00
48	AQP-AK-19-038-247	Vazhdimi i hostingut të web faqes së www. Kosix.net për nevojat Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	€ 215.16	€ 215.16

49	AQP-AK-19-040-121	Furnizimi, instalimi dhe implementimi i e-Kioskut sipas kërkesave dhe nevojave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	€ 19,000.00	€ 18,500.00
50	AQP-AK-19-041-136	Furnizimi me libra për nevoja të Keshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor	€ 5,000.00	€ 4,496.00
51	AQP-AK-19-042-147	Furnizim me kafe për nevojat e ARKEP-it	€ 980.00	€ 980.00
52	AQP-AK-19-043-221	Ofrimi i shërbimeve të internetit për nevojat e agjencive të pavarura	€ 4,800.00	€ 1,053.00
53	AQP-AK-19-044-221	Sigurimi i automjeteve për Agjencionet e Pavarura	€ 106,750.00	€ 59,009.22
54	AQP-AK-19-045-136	Furnizime me klima për nevojat e FKPK	€ 3,600.00	€ 2,700.00
55	AQP-AK-19-046-147	Blerja dhe instalimi i sensorëve për alarm të zjarrit dhe sensorit të temperaturës për AKK-në	€ 600.00	€ 600.00
56	AQP-AK-19-047-147	Furnizim me fotoaparate digjitale profesionale për nevojat e KRPP -së	€ 900.00	€ 900.00
57	AQP-AK-19-048-121	Pjesa (lot) 2-Furnizim me pajisje harduerike për virtualizim	€ 20,000.00	€ 13,298.00
58	AQP-AK-19-048-121	Pjesa (lot) 3 Furnizimi me pajisje dhe zhvillimi i shërbimeve të reja në KOSIX	€ 20,000.00	€ 12,969.00
59	AQP-AK-19-049-221	Publikimi i njoftimeve në gazetën ditore për nevojat e Agjencive të Pavarura	€ 10,600.00	€ 64.10
60	AQP-AK-19-050-147	Furnizim me regjistratore special për arkivim të dokumenteve	€ 995.00	€ 880.00
61	AQP-AK-19-051-147	Furnizim me kutija për dhurata për ACC-en	€ 500.00	€ 500.00

62	AQP-AK-19-052-225	Avancimi i bazës së të dhënave të Akademisë së Drejtësisë	€ 13,000.00	€ 11,750.00
63	AQP-AK-19-053-136	Furnizim me material higjienik për nevojat e FKPK-së	€ 3,000.00	€ 2,331.40
64	AQP-AK-19-054-236	Lot I - Ri dizajnimi dhe zhvillimi i Web faqes së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	€ 6,000.00	€ 4,890.00
65	AQP-AK-19-054-236	Lot II - Zhvillimi dhe Ri-dizajnimi i WEB-it AIP	€ 2,000.00	€ 1,350.00
66	AQP-AK-19-055-121	Pjesa 1 - Furnizim me PC dhe Laptop për nevojat e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike	€ 30,000.00	€ 25,663.00
67	AQP-AK-19-055-121	Pjesa 2 - Furnizim me pajisje të ndryshme të IT-së për nevojat e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike	€ 5,600.00	€ 5,290.00
68	AQP-AK-19-055-121	Pjesa 3 - Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	€ 3,000.00	€ 2,862.00
69	AQP-AK-19-055-121	Pjesa 4 - Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Organit Shqyrtues të Prokurimit	€ 4,000.00	€ 2,275.00
70	AQP-AK-19-055-121	Pjesa 6 - Furnizim me çanta për nevojat e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës	€ 2,600.00	€ 2,574.00
71	AQP-AK-19-055-121	Pjesa 7 - Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit	€ 4,200.00	€ 3,423.00
72	AQP-AK-19-057-247	Dizajn dhe llogo e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Dizajn dhe rroll-up banera	€ 900.00	€ 900.00


73	AQP-AK-19-058-121	Pjesa 2 - Furnizim me pajisje te IT-se per nevojat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.	€ 5,400.00	€ 5,028.00
74	AQP-AK-19-059-147	Furnizim me material higjienik - letër për duar dhe letër tualeti për nevojat e Autoritetit të Aviacionit Civil	€ 990.00	€ 975.86
75	AQP-AK-19-060-147	Furnizim me telefona fiks për nevojat e zyreve qendrore dhe regionale të ANJF	€ 510.00	€ 510.00
76	AQP-AK-19-062-136	Botime për nevoja te Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore	€ 4,500.00	€ 1,775.00
77	AQP-AK-19-063-536	Renovimi i sallës se mbledhjeve dhe hyrjes se objektit receptionit për nevojat e ARKEP-it	€ 9,500.00	€ 8,252.00
78	AQP-AK-19-064-247	Servisimi dhe mirëmbajtja e aparateve të përkthimit të Akademis ë se Drejtsisë	€ 995.00	€ 995.00
79	AQP-AK-19-065-547	Ngjyrosjen mureve të zyrave regionale të ANJF në Prizren, Gjakovë dhe Mitrovicë, furnizimin e shiritave, ivericës për mbrojtjen e murit dhe vendosjen e një dritare.	€ 930.00	€ 925.00
80	AQP-AK-19--066-147	Furnizim me mbathje per nevojat e Autoritetit te Aviacionit Civil	€ 960.00	€ 960.00
Totali 01.01.2019 deri 31.12.2019			€ 1,869,144.82	€ 1,437,889.04
Totali i vlerës se mjeteve të kursyera				€ 431,255.78
Përqindja e kursimeve				23.07%

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën Nr. 3 ku shihet se vlera e parashikuar e aktiviteteve të prokurimit nga njësitë kërkuese që kanë bërë kërkesa pranë Agjencisë Qendrore të Prokurimit për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2019 është **€ 1,869,144.82** ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 është **€ 1,437,889.04**. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, në vitin 2019 është arritur që të kursehen mjete buxhetore në vlerë prej **€ 431,255.78** apo shprehur në përqindje **23.27%**. Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur fal transparencës, punës profesionale që kanë treguar zyrtaret e Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta dhe bashkëpunimit të mirëfillte me zyrtaret e Autoriteteve Kontraktuese për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit.


TABELA 4

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS VITEVE						
Nr	Lloji i prokurimit	Vlera e kontratave			Vlera e kursimeve ne përqindje për vitin 2017	Vlera e kursimeve ne përqindje për vitin 2018
		2017	2018	2019		
1	Vlera e Parashikuar	1,599,751.08€	1,186,044.12€	1,869,144.82 €		
2	Vlera e Kontraktuar	1,282,334.29€	1,032,880.41 €	1,437,889.04 €	19.84%	12.92%
3	Vlera e kursimeve	317,416.79€	153,163.71 €	431,255.78 €		23.07%

Grafika 1



Grafika 2



Aktivitetet tjera të zyrtarëve të Drejtoratit për Prokurime të Veçanta

- Konform dispozitave ligjore, kemi përgatitur Raportin Vjetor për Kontrata të nënshkruara për vitin fiskal 2019 (formën standarde të KRPP-së);
- Kemi hartuar raportin vjetor të punës dhe aktivitetëve të Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta për vitin fiskal 2019 dhe të njëjtin e kemi dërguar të Drejtori i Përgjithshëm i AQP-se;
- Konform Neni 95, paragrafi 4, sipas kërkesave të disa Autoriteteve Kontraktuese, kemi dhënë mbështetje dhe këshilla në kryerjen e disa aktivitetëve të prokurimit;

Përveç rezultateve të arritura, Drejtorati i Prokurimeve të Veçanta gjatë realizimit të objektivave për vitin 2019 është ballafaquar edhe me disa probleme dhe vështirësi, ku me të theksuarat kanë qenë:

- Numri i vogël i zyrtarëve të prokurimit, ku dihet se më ndryshimet e LPP-së, këtij Drejtorati i janë shtuar përgjegjësitë për zhvillimin e aktivitetëve të prokurimit për 16 Agjenci të Pavarura (Neni 21A) dhe kërkesat që parashtrihen nga Autoritetet Kontraktuese e të cilat aprovohen nga Ministri i Ministrisë së Financave (Neni 95, paragrafi 4).
- Mos harmonizimi i planeve të prokurimit të Agjencive të Pavarura, ku shpesh herë jemi obliguar që të zhvillojmë disa aktivitete të prokurimit për mallra apo shërbime të njëjta, por në periudha të ndryshme kohore;
- Hartimi jo profesional i specifikave teknike nga Autoritetet Kontraktuese;
- Propozimet nga Autoritetet Kontraktuese të anëtarëve për pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit të ofertave pa përgatitje adekuate profesionale me natyrën e furnizimeve, shërbimeve, etj, për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit;

Për të mos u ballafaquar me probleme të njëjta në vitet e ardhshme rekomandojmë që menaxhmenti i Agjencisë Qendrore të Prokurimit të ndërmerr këto veprime:

- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i punëtorëve në të cilat do të marrin pjesë zyrtarët përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe zyrtarët përgjegjës të AQP-se për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit;
- Të kërkohej nga Autoritetet Kontraktuese të dërgojnë kërkesat për zhvillimin e aktivitetëve të prokurimit në AQP që specifikat teknike t'i hartojnë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me depozitat e LPP dhe në komisione të vlerësimit të ofertave të propozojnë anëtarë që kanë njohuri profesionale lidhur me mallrat, shërbimet, punët, etj, që janë duke u zhvilluar aktivitetet e prokurimit
- Dërgimi i stafit të Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta në seminare dhe trajnime në vend dhe jashtë vendit ku ligjërohen tema nga zhvillimi i praktikave më të mira të prokurimit publik;

Kërkesat për vitin 2020 për përmbushjen e planeve dhe obligimeve:

- Rritja e numrit të zyrtareve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit;
- Shtimi i fondeve për trajnime dhe për mbulimin e shpenzimeve për angazhimin e ekspertëve në hartimin e termave të referencës;
- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i një punëtorie në të cilin do të marrin pjesë zyrtarët përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe zyrtarët përgjegjës të AQP-së për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit për vitin fiskal 2020;
- Organizimi i dy punëtorive, një më zyrtarë të nivelit qendror dhe një më zyrtarë të nivelit lokal për harmonizimin e kërkesave dhe qëllimeve dhe për uniformimin e dokumenteve për paraqitjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike;
- Të kërkohet disiplinë dhe përgjegjësi e njësisë kërkuese, përkatësisht e autoriteteve kontraktuese, në ofrimin e shënimeve dhe specifikimeve teknike për aktivitetet e prokurimit që duhet t'i zhvillojë AQP;
- Të kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese që dërgojnë kërkesa për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në AQP që specifikat teknike ti hartojnë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me depozitat e LPP;
- Të kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese për të cilat zhvillohen aktivitetet e prokurimit që për pjesëmarrje në komisione të vlerësimit të ofertave të propozojnë anëtarë që kanë njohuri lidhur me mallrat, shërbimet, punët, etj, që janë duke u zhvilluar aktiviteti i prokurimit;
- Dërgimi i zyrtarëve të prokurimit në seminare dhe trajnime në vend dhe jashtë vendit ku ligjërohen tema nga zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit sipas Rregulloreve dhe legjislacionit të Bankës Botërore, për të marrë praktikat më të mira në fushën e prokurimit.

Arsyetim

Përkrahja institucionale, financiare dhe kadrovike e AQP-së do të rezultojë me kursime milionëshe, me kursim të kohës dhe mjeteve për AK-të.

Po ashtu, janë të pritshme edhe përzgjedhje të kompanive serioze me ç' rast pritet të sigurohen furnizime dhe shërbime më cilësore.

AQP, gjatë punës së vet do të angazhojë edhe zyrtarë nga AK të nivelit lokal dhe qendror të cilët mund të fitojnë përvoja në punë ekipore në vlerësimin e projekteve me vlera të mëdha.

Një AQP e përkrahur do të jetë një storie suksesi për Ministrinë e Financave dhe Transfereve dhe për AK, duke siguruar kontrata të dobishme dhe duke përmbushur arsyen e ekzistimit të saj.

Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për vitin 2019

Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për vitin 2019, përfshinë aktivitetet e kryera sipas përshkrimit të vendit të punës dhe detyrave shtesë nga zyrtarë të cilët janë në kuadër të këtij drejtorati:

- Drejtor i Drejtorit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Përkthyesja e gjuhës angleze;
- Përkthyesja e gjuhës serbe;
- Zyrtarja e lartë e personelit;
- Zyrtarja ligjor;
- Zyrtar i logjistikës.

Drejtor i Drejtorit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme ka menaxhuar dhe arritur objektivat dhe aktivitetet e Drejtoratit përkatës, si në vijim:

- Planifikimi i buxhetit, përgatitja e planit të rrjedhës së parasë;
- Përgatitja dhe dorëzimi i barazimeve tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, njëvjeçare dhe barazimi me Departamentin e Thesarit/MF;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për burimet njerëzore, logjistike dhe përkthime;
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistike etj.
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i proceseve të rekrutimit dhe çështjeve lidhur me BNJ, logjistike etj.
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për zyrën e përkthimeve.

Në tabelë janë pasqyruar shpenzimet që janë kryer gjatë vitit fiskal 2019, gjithsejtë njëqind e dhjetë (110) pagesa, nga tri (3) kategori të ndryshme ekonomike.

Kategoria: Mallra dhe shërbime /Paga dhe mëditje	Shuma
Mallra dhe shërbime	43,515.59 €
Konunali/telefoni fikse	750.04 €
Paga dhe mëditje – Janar-dhjetor ,2019	117.796.59 €
Totali	162.062.22 €

Ndërsa, sa i përket burimeve njerëzore, gjatë vitit 2019, janë kryer tri {3} procese të rekrutimeve, një (1) avancim, një (1) transfer dhe një (1) kontratë mbi vepër.

PJESËMARRJA NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE

Gjate vitit 2019 Drejtori Ekzekutiv ka marrë pjesë në Nen-komitetin e Stabilizim Asocimit për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetësi.

TRAJNIMET

Agjencia Qendrore e Prokurimit me qëllim të ngritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit të stafit, me synim përballimin në mënyrë sa më efikase të detyrimeve ligjore edhe gjatë vitit 2019, kujdes të veçantë i ka kushtuar trajnimit të anëtarëve dhe personelit të institucionit të AQP-së.

Zyrtarët e AQP-së kanë ndjekur trajnime për “Programin e Avancuar për Prokurim” nga data 09.09.2019 deri më 14.11.2019, i organizuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe projektin e USAID-it Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM), me gjithsej nëntë (9) module, i ndjekur dhe përfunduar me sukses nga nëntë (9) zyrtarë të AQP-së; Drejtori i Përgjithshëm, katër (4) zyrtarë nga Drejtorati për Prokurime të Centralizuara, tre (3) zyrtarë nga Drejtorati për Prokurime të Veçanta dhe një (1) zyrtar nga Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme. Të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata të përhershme.